

## AUTORIZIM KAMIONI PËR QARKULLIM NË QYTET PËR TRANSPORT MALLRASH NË MASË

<u>Emri i Shërbimit</u>	<b>Kërkesë për marrjen e autorizimit të kamionit për qarkullim në qytet për transport mallrash në masë</b>
<u>Përshkrim i Shkurtër</u>	Ky shërbim mundëson dhënien e autorizimit të kamionit për qarkullim në qytet për transport mallrash në masë për arsye të ndryshme.
<u>Baza ligjore:</u>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ligji Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”</li> <li>▪ Ligj Nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”.</li> <li>▪ Ligj Nr. 37/2014 për disa shtesa në ligjin Nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar.</li> <li>▪ Ligj Nr.10137, datë 11.5.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.”</li> <li>▪ Udhëzim Nr. 15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar me Udhëzim Nr.5, datë 17.2.2011</li> </ul>
<u>Përfituesi</u>	Bizneset
<u>Zyra Përgjegjëse</u>	Zyra/Specialisti i transportit
<u>Afati</u>	15 ditë
<u>Tarifa</u>	Bazuar në paketën fiskale
<u>Dokumente të nevojshëm</u>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Certifikata e regjistrimit në organin tatimor ose QKB;</li> <li>▪ Ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit lëshuar nga QKB (në rast se është i nevojshëm, për personat juridikë);</li> <li>▪ Leja e qarkullimit (për çdo automjet); Certifikata e kontrollit teknik (për çdo automjet); Kontrata e sigurimit (për çdo automjet); Leja e drejtimit;</li> <li>▪ Kontrata e punësimit (në rast se drejtuesi nuk është pronar);</li> <li>▪ Vërtetim që janë likuiduar detyrimet vendore;</li> <li>▪ Dokumentacion që argumenton arsyet e qarkullimit në qytet.</li> </ul> <p><i>*Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje të noterizuara.</i></p>
<u>Dokumenti/at e prodhuar si rezultat i shërbimit. (outputs)</u>	Autorizim
<u>Sporteli ku drejtohet qytetari për marrjen e shërbimit</u>	Sporteli në Bashki Sporteli i shërbimit të taksapaguesve Sporteli në Njësinë Administrative